

VENDIM
Nr. 266, datë 29.4.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.17, DATË 15.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE
RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT
NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE
PROFESIONALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) Në kreun II, “Kriteret e aplikimit”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - i. Në pikën 1, fjalët “... 3 (tre) ...” ndryshohen me “... 1 (një) ...”;
 - ii. Në shkronjën “P”, të pikës 4, fjalët “... 4 (katër) ...” ndryshohen me “... 2 (dy) ...”;
 - iii. Në pikën 5, pas fjalëve “... aplikojnë në ...” shtohen “... një ose ...”.
- b) Në pikën 3, të kreut III, “Programet, përfituesit dhe mbështetja”, bëhen këto ndryshime:
 - i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:
 - “a) Programi i praktikave profesionale ka si qëllim të garantojë tranzicion të shpejtë në tregun e punës, në të njëjtën fushë ose në një fushë të ngjashme me atë, në të cilën ka studiuar i diplomuari ose nxënësit e diplomuar në shkollat e mesme profesionale publike apo private, për një kohëzgjatje 6-mujore.”.
 - ii. Në shkronjën “b”, fjalët “... 24 (njëzet e katër) ...” ndryshohen me “... 36 (tridhjetë e gjashtë) ...”.
- c) Fjalja hyrëse e pikës 2, të kreut IV, “Rregullat dhe procedurat e zbatimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:
 - “Punëdhënësit paraqesin kërkesën për përfshirjen në program nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, duke ngarkuar dokumentacionin e mëposhtëm: “.
- ç) Kudo në përmbajtje të vendimit, fjalët “... aplikues/aplikim ...” ndryshohen me “... kërkuar/kërkesë ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj